

FËMIJËT DHE TELEVISIONI, PËRVOJË DHE MONITORIM

1. Hyrje.

Televizioni është mjete më i përhapur i komunikimit publik. Ai ka rol të padiskutueshëm në formimin e opinionëve qytetare të të rriturit dhe ndikim shumë të rëndësishëm në ngjizjen e karakterit të fëmijët dhe adoleshentët.

Ndjekja e televizionit mbetet mënyra kryesore e argëtimit për shumicën e shtresave të popullsisë. Është vërejtur se, në shoqërinë pasive të programeve që servirin transmetuesit televizivë, komuniteti harxhon sot rreth 30% të kohës së vet aktive. Sidomos të fëmijët, në kushtet e mungesës së formave të tjera të zbavitjes, veprimtaria kryesore e ditës mbetet ndjekja e programeve televizive, si në mënyrë individuale ashtu edhe kolektive, apo më saktë familjare.

Sot programet televizive janë të shumëllojshme. Larmia e tyre ndryshon nga stacioni në stacion dhe nga ora në orë. Nga të gjithë pranohet me shqetësim “rreziku mediatik”, në lidhje me trysinë që shkakton televizioni kryesisht të fëmijët, nëpërmjet teprimit me skena dhune të pajustificuar dhe pamjeve e sekuencave erotike të papërshtatshme për moshën. Nuk duhen lënë mënjane edhe shqetësimet lidhur me elemente të tjera me efekte dëmtoese të të vegjlit, si p.sh. përdorimi i fjalorit vulgar dhe të tjera të ngjashme me këtë. Në një studim të KKRT-së, për respektimin e normave etiko-morale nga transmetuesit tv, dilte se rreth 90% e të anketuarve mendonin se teprohet me dhunën dhe seksin në ekranet televizive. Komunikimi vulgar, dhuna dhe skenat e tepruara erotike në ekranet tona, përcillen edhe nga ato grupmosha, që me ligj duhet të mbrohen prej tyre dhe si rrjedhim kërcënohet zhvillimi fizik, mendor dhe moral i fëmijëve.

2. Legjislacioni

Në aktet ndërkombëtare ka nene apo paragrafe që kanë të bëjnë jo vetëm me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi, por dhe të fëmijëve në veçanti.

Për shembull, në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve thuhet se “Shtetet njohin funksionin e mjeteve të komunikimit masiv dhe garantojnë që fëmijët të marrin informacion nga burime të ndryshme, sidomos nga ato që synojnë të rrisin mirëqënien e tyre shoqërore, shpirtërore dhe morale, si dhe shëndetin fizik dhe mendor.” E më poshtë theksohet se “shtetet detyrohen të marrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e dhunës fizike, ose mendore”

Në fushën e medias elektronike, përmbushja e këtyre detyrimeve nga ana e shtetit pasqyrohet në ligjin që rregullon veprimtarinë radiotelevizive dhe që, në çdo vend, ka karakter kombëtar. Me këtë kuptohet që një pjesë e ligjit duhet të ketë nene që mbrojnë zhvillimin fizik, emocional apo psikologjik të fëmijëve, interesat dhe të drejtat e tyre morale nga fusha të tilla si pornografia, seksi, dhuna, përdorimi i një fjalori banal dhe deri te vulgarizimi i gjuhës amtare në radio dhe televizion, apo përdorimi i formave të atilla të humorit, që cënojnë dinjitetin e njeriut.

2.1 Mbrojtja e fëmijëve në Ligjin 8410, dt. 30. 09. 1998

2.1.1 Në fushën e programeve

Ligji Nr.8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” dhe amendamentet e tij, rregullojnë veprimtarinë e medias elektronike në territorin e vendit tonë. Kjo veprimtari përfshin si prodhimin ashtu edhe transmetimin e programeve dhe informacioneve nëpërmjet valëve elektromagnetike.

- Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohen parimet themelore të zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive, ku midis të tjerave theksohet se: **“në këtë veprimtari respektohen në mënyrë të veçantë të drejtat, interesat dhe kërkesat morale e ligjore për mbrojtjen e të miturve”**.
- Në nenin 36 të këtij ligji thuhet se programet radiotelevizive “... respektojnë dinjitetin vetjak dhe të drejtat themelore të njeriut, ... të drejtat e fëmijëve dhe adoleshentëve...”
- Sipas nenit 38, “Në radio dhe televizion nuk lejohet të jepen programe që nxisin dhunën, ..., ndërsa në pikën 4 të po këtij neni ndalohet “ prodhimi dhe transmetimi i programeve pornografike”.
- **“Filmat dhe programet, që janë të ndaluar të shfaqen në kinema, nuk shfaqen në televizion”**. Kështu përcaktohet në nenin 43 të ligjit, duke shtuar edhe se filmat e ndaluar për fëmijët nën moshën 14 vjeç nuk shfaqen në televizion, as pjesërisht prej orës 6.00 deri në orën 2.00 të ditës tjetër.

2.1.2 Në fushën e publicitetit

- Në nenin 56 të ligjit Nr. 8140, të titulluar “Mbrojtja e të miturve” thuhet se nuk lejohet të jepen, në radio dhe televizion, reklama që nxisin sjellje, të cilat rrezikojnë shëndetin dhe zhvillimin normal psikik të fëmijëve. Reklamat e destinuara për fëmijët, ose kur realizohen me fëmijë, të jenë të tilla që të shmangin çdo gjë që dëmton interesat dhe veçantitë e moshës së tyre.
- Neni 57 detyron që reklamat e pijeve alkoolike të mos u drejtohen në veçanti fëmijëve dhe ata të mos lejohen të paraqiten në reklamë me pije alkoolike në duar, ose në ndonjë mënyrë tjetër.

2.1.3. Koment i shkurtër për ligjin

Ligji “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në RSH” jep rekomandime të përgjithshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të miturve, bile në shumicën e rasteve duke mos ju referuar direkt atyre, por duke patur si subjekt të gjitha moshat. Kështu në kreun e dispozitave të përgjithshme dhe në atë të programeve nuk gjenen nene të veçanta që të kenë si subjekt mbrojtjen e fëmijëve, bile as paragrafe dhe, për çudi, këtë e gjejmë vetëm te

kreu i reklamave, duke pasqyruar kështu edhe një mungesë koherence të trajtimit të problemit.

Ligji shqiptar nuk specifikon përmbajtjen konkrete të transmetimit që dëmton fëmijën, përveçse në nenin 38, ku është vështirë të gjykosh se për cilat programe bëhet fjalë dhe që nuk përbën mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët (psh. jo vetëm filmat me dhunë, por edhe vetëm skenat me dhunë të tejskajshme dëmtojnë zhvillimin normal të të miturve), si dhe në kreun e reklamave, ku përmendet që fëmijët nuk duhet të paraqiten në reklamë me pije alkoolike në duar.

Gjékundi nuk përmendet përdorimi i fjalorit vulgar si element që dëmton shëndetin mendor dhe formimin gjuhësor të fëmijës.

Pamjaftueshmëria e trajtimit të problemit në dokumentacionin ligjor dhe posaçërisht në kreun e programeve, e vështirëson zbatimin e ligjit nga ato media private, që duan të jenë ligjërish në rregull, duke bërë që shpesh të futen koncepte dhe parime personale, për atë që duhet, apo nuk duhet transmetuar.

Gjatë muajit Shtator'07 u monitoruan disa operatorë radiotelevizivë në lidhje me temën e mbrojtjes së fëmijëve nga “reziku mediatik”. Nuk kishim qëllim hartimin e statistikave, por vetëm identifikimin e rasteve, paraqitjen e shembujve të programeve, apo sekuencave të programeve ku abuzohet me fëmijët, jo vetëm nga neglizhenca, por edhe nga mungesa e përgjegjësisë.

Me këtë synim është kryer vëzhgimi i programeve të 6 televizioneve: “Top Channel”, “Vizion +”, “News 24”, “Shijak Tv”, TVSH dhe TVA.

Siç do të vërejmë, shembujt e keqtrajtimit të fëmijëve përfshijnë *edicionet informative*, *emisione te tjera*, por edhe ndonjë *emision për fëmijë*, madje edhe *reklamat*.

I . Edicionet informative

1. Jo rastësisht, po e fillojmë me një rast të para disa viteve. Një televizion serioz transmeton intervistën e një fëmije, të cilit i janë vrarë prindërit. Dëgjohet sinkron fëmija, që thotë se i akuzuari për këtë krim, jeton në burg më mirë se ai vetë, sepse atje i janë krijuar të gjitha kushtet, duke përfshirë edhe televizorin. Fëmija kërkon dënimin me vdekje të vrasësit të prindërve. Në kronikë është e panevojshme deklarata e një fëmije, që kërkon ekzekutimin e vrasësit të prindërve të tij. Duke parë dhe dëgjuar këtë intervistë, mendojmë se “kur intervistohen persona të përfshirë nga inati, ose nga dhimbja, është mirë që të shmangen nënkuptimet, që japin idenë e dëshirës për të shfrytëzuar emocionet e tyre. Televizioni nuk duhet të kërkojë të tilla efekte, që pjesës më të madhe të publikut do t’u duken të panevojshme dhe shpesh cinike”. Përfundimi i mësipërm është i kolegëve tanë të RAI-t për një rast të ngjashëm. Pra, që në fillim, do të thoshim që problemi i keqpërdorimit të fëmijëve nga media elektronike nuk është vetëm shqiptar.
2. Në kronikën “Arrestohet bashkëshorti”, të transmetuar nga “Vizion +” më datën 25. 09. 2007, përveç abuzuesve të ndaluar nga policia, shfaqet edhe vajza e shfrytëzuar për prostitucion. Kemi të bëjmë me rastin e një vajze 17 vjeçare, e identifikuar nga media, e cila shfrytëzohet nga bashkëshorti. Pra, nuk ruhet

- anonimati i një vajze adoleshente, viktimë e shfrytëzimit. Identifikimi i figurës së kësaj vajze minorene, paçka se e martuar, krijon probleme shumë të rënda për integrimin e mundshëm të saj, sërish, në shoqëri. Ky integrim është detyrë e shoqërisë, por edhe e medias. Në këtë rast media bën të kundërtën.
3. Le të ndalemi në një program të suksesshëm, “Me zemër të hapur”, të transmetuar nga “News 24”, në datën 21. 09. 2007. Aty trajtohet problemi i një familjeje të ndarë, në mes të saj qëndron një fëmijë i mitur, për të cilin kujdeset babai i tij. Në këtë emision, ku pretendohet të minimizohen disa probleme sociale e familjare, përdoret figura e fëmijës e pambrojtur nga opinioni publik. Fëmija, në një foto të zmadhuar nga i ati, përdoret në formë presioni psikologjik. I ati përdor ekranin dhe foton e fëmijës për të ribashkuar familjen e ndarë. Nga ana tjetër, nëna presupozon se ky fëmijë po rritet në një mjedis të dhunshëm, nga ku ajo vetë kishte dalë. Në këtë rast, keqpërdorimi dhe dhunimi i të drejtave të fëmijës shfaqet, më së paku, në pikat që vijojnë: **A.** Identifikimi i fëmijës nuk ruan privatësinë e një fëmije që po rritet në një mjedis jonormal. Identifikimi i qartë i figurës së tij mund të ketë probleme për integrimin e tij në shoqëri. Komuniteti mund ta paragjykojë e mund të kthehet për të më i dhunshëm sesa i ati në familje. **B.** Përdoret fëmija si mjet presioni për të zgjidhur problemet e çiftit. **C.** Në jetë fëmija është shkak i bashkimit të familjeve të ndara, por kjo nuk mund të përdoret nga media duke publikur figurën e tij.
 4. Në kronikën e datës 19. 09. 2007, për minatorin e vdekur, nga “News 24” shfaqen qartë fëmijët e viktimës. Me çdo kusht kërkohet të paraqitet gjendja e rënduar psikologjike e të dy fëmijëve. Në këtë kronikë shfrytëzohet figura e fëmijëve për të dhënë të shikuesit gjendjen e varfër ekonomike të krejt familjes. Fëmijët në kronikë janë të rënduar emocionalisht, veçanërisht djali i vogël 6 vjeçar, i cili përletot gjatë gjithë paraqitjes në ekran. Për këtë lloj paraqitjeje të mjeruar të fëmijës, nuk mungon preokupimi i më të rriturve, në dhomën e shtëpisë, siç nuk mungon as neglizhenca e gazetarit në dhomën e montazhit.
 5. Në kronikën televizive “Dhunohen personat e paaftë”, të transmetuar në dt. 10. 09. 2007, nga TCH, pasqyrohet keqtrajtimi i fëmijëve me probleme të shëndetit mendor në qendrën e trajtimit ditor të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në qytetin e Korçës. Shqetësimi i prindërve, apo të afërmeve të fëmijëve, që mendohet ose pretendohet të jenë abuzuar psikologjikisht, apo seksualisht, nga kujdestarët e tyre, përbën një lajm vërtet shqetësues dhe tronditës, por nga ana tjetër, transmetimi me figurë, i pamjeve të këtyre fëmijëve në ekran, të cilët në ndonjë rast kanë mbuluar edhe fytyrën me duar, aq më tepër që i përkasin një kategorie të paaftë fizikisht e mendërisht, është një shembull konkret i mosrespektimit të normave etike të pasqyrimin të fëmijëve në media. Ky lajm, në po të njëjtën ditë, transmetohet edhe nga Tv “KLAN”. Lajmi shoqërohet me pamje filmike të fëmijëve në grup që përfitojnë shërbime nga kjo qendër. Por nuk mungojnë pamjet e afërta të fëmijëve me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor dhe fizik. Po ky lajm transmetohet nga TVA në datën 11. 09. 2007, duke u fokusuar tek intervistat me drejtuesit e qendrës dhe, në një farë mase, duke shmangur fëmijët.

6. Në lajmin e datës 10. 09. 2007, të transmetuar nga TVSH-ja, tregohet për një fëmijë 6 vjeçar të braktisur nga prindërit dhe të sëmurë me talasemi. Reporterja, gjatë rrëfimit të ngjarjes, interviston edhe fëmijën 6 vjeçar:

Reporter: - *Po ti, shkon tek nona në shtëpi?*

Fëmija: - *Po!*

Reporter: - *Kur shkon?*

Fëmija: - *Pasnesër do iki!*

Reporter: - *Dhe sa do rrish?*

Fëmija: - *Do marr kokrrat dhe pasnesër do iki!*

Reporter: - *Ç'janë këto kokrra?*

Fëmija: - *Që pij tek goja.*

Kërkohej efekti, “skupi”, duke e dramatizuar ngjarjen përmes intervistimit të fëmijës së sëmurë.

7. Në një nga lajmet e transmetuar nga TCH, më dt. 13. 09. 2007, bëhet fjalë për vrasjen e një gruaje nga i shoqi. Në kronikën e transmetuar jepen pamje të afërta të fëmijëve të viktimës, të cilët qëndrojnë të ulur pranë murit dhe duken të trembur para kameras. Njëri prej tyre ka mbuluar fytyrën me duar, kurse tjetri i ka duart në kokë. Reporterja e lajmit ka intervistuar vjehrrën e viktimës, e cila, ndërkohë, mban në krahë një prej fëmijëve, tashmë jetimë.

Reporter: - *Nëne, çfarë tipi ishte Fitnetja? (nusja)*

Vjehrra: - *Fitnetja se di sun e di ç'a tipi. Ishte, ka qenë me nerva.*

Reporter: - *Me çfarë i dha fund jetës?*

Vjehrra: - *Jetës i ka dhënë fund me helm. Ka pi helm. Se ç'a helmi ishte, nuk di nona. Kur him mrena ishte krepshnik e zezë...*

Edhe fëmija e viktimës në krahë, edhe mënyra e vdekjes, vrasjes, apo vetëvrasjes janë detaje që nuk i shkojnë përshtat moshës së fëmijës dhe profesionalizmit të gazetarit.

8. Në “Vizion +”, në datën 19.09.2007, në reportazhin “Një ditë drejt shkollës”, përdoren një grup fëmijësh, nxënës të një shkolle private, e evidentuar me emër, për të trajtuar një problem, që nuk u përket vetëm fëmijëve, siç është trafiku i rënduar në kryeqytet. Këtu nuk është problem identifikimi i fëmijëve me figurë dhe zë, që shprehin shqetësimin e mosmbërritjes në kohën e duhur, në orar, për shkak të trafikut. Trafiku nuk është problem i fëmijëve. Fëmijët përdoren. Përdorja, qoftë edhe për reklamën e shkollës, është e dëmshme.
9. Në TCH, Vizion Plus, dhe Tv Klan është transmetuar kronika me përmbajtjen e një videoje erotike, të realizuar me një vajzë minorene 16 vjeçare, viktimë e një filmimi të padëshiruar. Kjo kronikë, në datën 02. 10. 2007, është servitur si lajm i bujshëm, me tituj sensacionalë. Në këtë kronikë mungon kujdesi për të respektuar anonimatën e vajzës, e cila është lehtësisht e identifikueshme. Kjo gjë mund të

krijohet probleme të rënda psikologjike te vetë personi, siç edhe ka ndodhur në këtë rast. Në Tv Klan, problemi trajtohet më tepër si dukuri që mund të ndikojë në shumë anë të jetës shoqërore dhe psikologjike të një minoreneje. Pasojat e gjithë kësaj shfaqjeje televizive dalin qartë në kronikën e transmetuar nga Tv Klan, në dt. 12. 10. 2007, ku njoftohet se 16 – vjeçarja, jo vetëm ishte larguar nga shkolla, por kishte përfunduar në një gjendje të rëndë psikologjike, që pohohej nga vetë familjarët e saj.

10. Pothuajse në të gjitha mediat elektronike janë transmetuar pamjet e një të riu, teksa i vë flakën vetes në Parkun “Rinia”, në mes të Tiranës. Transmetimi i këtyre pamjeve makabre, ndikon negativisht te shikuesit, tepër negativisht tek fëmijët dhe adoleshentët dhe janë vërtet tronditëse për familjarët e viktimës. Ky filmim transmetohet edhe në programe jashtë informacionit, siç është rasti i emisionit “Zonë e lirë”, në Vizion Plus.
11. Gjatë muajit Shtator është publikuar një informacion që ka të bëjë me dy fëmijë të prekur nga Sida, të cilët mësojnë në një nga shkollat e kryeqytetit. Mediatizimi i një rasti të tillë ka çuar në debate publike mes shkollës, familjarëve të fëmijëve të tjerë të së njëjtës klasë dhe instancave shtetërore të arsimit e të shëndetësisë. Rasti i mësipërm është një shfaqje e atyre dukurive, për të cilat, shoqëria në përgjithësi dhe media në veçanti duhet të kenë kujdes të posaçëm, në mënyrë që problemi të mos ekzagjerohet, aq sa të vështirësojë zgjidhjen e të gjenerojë probleme e konflikte të reja. Identifikimi i këtyre fëmijëve të mitur, të prekur nga një sëmundje e pashërueshme, mund të çojë në izolimin e plotë të tyre nga shoqëria.

II . Emisione për fëmijë

1. “Përrallë me piratë”, i përgatitur dhe transmetuar nga “Vizion+”, emision argëtues dhe edukativ. I ndërtuar në formën e një gare mes dy grupesh. Fëmijët mësojnë prej tij. Drejtuesi i emisionit përçon mesazhe pozitive te fëmijët në studio dhe në ekran.

2. “Bibloteka lëvizëse”, emision i përjavshëm për fëmijë, i transmetuar nga TVSH. Janë të ftuar shkrimtarë për fëmijë, të cilët diskutojnë për librat së bashku me fëmijët. Evidentohen vlerat e padiskutueshme të leximit. Pjesë përbërëse e këtij emisioni është nxitja dhe inkurajimi i talenteve të reja në fushën e letërsisë. Fëmijëve mund t’u lihet më shumë hapësirë për të folur.

3. Programi “On air selected”, i transmetuar çdo pasdite nga “Shijak Tv”, përbën një emision argëtues për adoleshentët. I ndërtuar në formën e ndërthurjes së telefonatave nga dejtuesit e emisionit me një temë të caktuar dhe këngëve përshëndetëse. Ja vlen të theksohet se gjuha e përdorur e drejtuesve adoleshentë, lë për të dëshiruar, pasi mënyra e tyre për t’u përshtatur në komunikim, nuk është ajo e duhura.

Shtimi i kanaleve televizive zgjeroi shumë mundësitë për të zgjedhur emisionet, por këto mundësi nuk janë aq të gjera për fëmijët. Ata gjejnë pak emisione kulturore, zbavitëse dhe shkencore, enkas për ta.

Në përgjithësi televizioni nuk paraqitet ende si një plotësues i edukimit shkollor dhe familjar të fëmijëve. Duke e parë televizionin më shumë si biznes, sesa si mjet edukimi, pronarët e shumicës së kanaleve televizive i kanë shmangur, ose i kanë lënë pas dore, programet e mirëfillta edukative dhe argëtuese për fëmijët.

III . Reklama

Reklama e sallamit ALSA

Të drejtat e fëmijëve mund të çënohen edhe përmes ndonjë reklame që, në dukje, duket sikur u vjen në ndihmë moshave të vogla. Kjo duket qartë në shembullin që vijon të reklamës së transmetuar në Top Albania Radio:

Një “bebe” e porsalindur, pa dhëmbë, ka nevojë për ushqimin e saj natyral. Dy fëmijë “kujdestarë”, pak më të rritur se “bebja”, i ofrojnë një produkt ushqimor, që të pushojë së qari. Në pamjen e parë, mesazhi i reklamës është se një nënë e re, mund ta zëvendësojë lehtësisht qumështin e gjirit me produkte të tjera, në këtë rast, sallamin. Gabimi i këtij zëvendësimi është i rëndë shkencërisht. Çënohet e drejta e fëmijës për t’u ushqyer me qumështin natyral të nënës së tij. Mesazhe të tilla mund të jenë artistikisht e komercialisht të gjetura bukur, por janë të papranueshme, të padrejta e të dëmshme. Në Europë është mjaft i njohur reagimi i shoqërisë, për një film vizatimor ku personazhi kryesor, i pëlqyeshëm nga fëmijët, përsërit herë pas here se nuk i pëlqejnë zarzavatet: realizuesit e filmit u gjobitën dhe e redaktuan tekstin e serialit vizatimor, pas vendimit të gjykatës.

Analogjia është e qartë për këdo dhe nuk ka nevojë për koment.

Shembujt e trajtuar më sipër, dëshmojnë se në median tonë elektronike, nuk zbatohen me përpikëri kërkesat e ligjit për respektimin e të drejtave të fëmijëve, rregullat dhe normat etike e morale, që shërbejnë për t’i mbrojtur ata nga rastet e keqpërdorimit të dhunës, të çënimit të personalitetit, të formimit e të edukimit të cunguar, me pasoja të rënda për sot, e sidomos për nesër.